



Republika e Kosovës  
Republika Kosova – Republic of Kosovo  
**ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT**  
**TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKE**  
**PROCUREMENT REVIEW BODY**



Organi Shqyrtues i Prokurimit (OSHP) – Rruga Migjeni (ish Banka e Ljublanës), Kati V-të, Prishtinë, Kosovë  
Tel: 383 38 312 309 email: [oshp@rks-gov.net](mailto:oshp@rks-gov.net)

## RAPORTI I EKSPERTIT SHQYRTUES

Eksperti Shqyrtues	Data e pranimit të ekspertit	Date e dorëzimit të raportit	Nr. i lëndës
<b>Shkelzen Hoxha</b>	<b>12.04.2024</b>	<b>19.04.2024</b>	<b>2024/0304</b>

### BAZA LIGJORE E SHQYRTIMIT

Me datën: 08.04.2024, OE “**TONI INGJINJERING**”- Prishtinë, ka parashtruar ankesë me nr: **2024/0304**, kundër njoftimit për kontratë, lidhur me aktivitetin e prokurimit: “**Mirembajtja e ndriçimit publik ( kontrate korrnize dy vjeqare)**” me nr. të prokurimit: “**617-24-1985-2-1-1**”, iniciuar nga Autoriteti Kontraktues (AK) – **KOMUNA SHTIME**. Autoriteti kontraktues ka zbatuar procedurë të hapur, lloji i kontratës: shërbim, vlera e parashikuar e kontratës: 150,000.00€.

Konform nenit 113, 114 të Ligjit Nr. 04 / L - 042, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 04 / L - 237, Ligjin 05 / L - 068, dhe Ligjin 05 / L - 092, Eksperti Shqyrtues i ka shqyrtuar pretendimet ankimore të OE ankues.

### DISPOZITAT E SHKELURA DHE PRETENDIMET ANKIMORE

Të pa kënaqur me kërkesen e AK- Autoriteti kontraktues – Komuna e Shtimes dhe në pajtim me nenin 108A të LPP-së parashtrojmë ankese për rishqyrtim kundër; Kërkesave diskriminuese mbi mundësitë teknike dhe profesionale 9.1 & 9.2:

Pas pranimit të dosjes nga platforma e-prokurimi dhe analizimit të saj, ne si OE të interesuar ne bazë të nenit 4.1.26 të LPP-se, për të marrë pjesë në këtë procedure të prokurimit, kemi kërku sgarime shtese të AK për 90% të kriteret të cilat mendojmë se janë diskriminuese, të pa drejta dhe të pa nevojshme lidhur me aktivitetin relevant të prokurimit dhe në kundërshtim të plotë me nenin 1, pika 1; 2 dhe 3; nenin 6, pika 1, nenin 7, pika 1; 2 dhe 6; neni 28, pika 2 dhe 10, të Ligjit të Prokurimit Publik të Kosovës në fuqi.

Per kriteret në vijim për të cilat kemi kerku nga AK sqarime shtese janë të kundërligjshme dhe kerko nga OSH. Ti verifikoi dhe te bejë analizë per secilen pikë dhe te merr vendim sipas ligjeve te prokurimit qe posedon ky organ,që sipa neve si OE duhet larguar nga kriteret e përzgjedhjes sepse, mendojmë se janë diskriminuese, të pa drejta dhe të pa nevojshme me aktivitetin relevant të prokurimit (ne bazë te natyres se punve dhe paramases se dhen ne dosje te tenderit,e qe dote kryhen ne ket kontratë 90% te tyre jan diskriminuese) te cilat poi cekim: Ne bazë te kerkesave te kerkuara nga Zyra e Prokurimit ne piken 9.1 dhe 9.2 Kërkesat mbi mundësitë teknike dhe/ose profesionale, sipas ktyre kerkesave ne piken 9.1 dhe 9.2 nuk kemi te bejm vetem me mirëmbajtje te ndriqimit publik por kemi te bejm edhe: Me mtrëmbajtje te rrugëve, kanalizimeve, me ndertimin e ndertesave dhe mirëmbajtje te tyre, me pastrimin e rrugëve, me bartje te puntorve apo nxansave. dmth. Ne ket dosje te tenderit egzistojn kriteret per te gjtha kto qka ne i cekem,por mungojn paramasat e tyre. Ne tash do tju kerkoj edhe do ju njoftojm per secilen paisje apo per secilin personel te stafi i kerkuar.

1.Ndriqimi publik ekziston dhe është i kryr ne disa forma:Rrjet ajror neper shtylla ekzistese te rrjetit elektrik dhe shtylla metalike vetem per ndriqim dhe forma tjeter rrjet nen tokso, jan te vendosura trupat ndriques lled, Atëher qka naduhet inxh.i qertifikuar per sistemin e menagjimit të efiqences te energjisë,sepse ky inxh. Ka te bej ma shum me projektim dhe llogaritje per ndoni projekt qe do te realizohet ne ndoni rrugë te pa ndrikuar nga fillimi deri ne perfundim.(per kto punë te kti tenderi nevoitet një ingjinjer i elektros ndersa qdo inxh. me teper nese një kompani e prezenton me letra ne dosje te tenderit ato jan vetem dokumente te shitura per ofertim e qe ai inxh. ska me qen ne realizim te kti projekti, ket e dinë edhe AK sepse munden me i verifiku OE qe kan dhe qe kan pas kontrata dhe me qfar stafi i kan realizu.)-per ket vetem një inxh. i elektros duhet te figuroi ne kerkesë ndersa kerkesa te pika a) duhet larguar si kerkesë.

2.Mirëmbajtja e ndriqimit publik është punë mobile sepse mbrenda një dite stafi punues me dy puntor teknik i kontrollojn dhe ndrrojn trupat ndriques ne disa rrugë psh. Ne rrugen Adem Jashri i ndrrojn dy trupa ndriques te djegur per disa minuta,tani kalojn te kerkesa meradhë ne rruget tjera e qe kto bahen permes autoshtepites, kshtu qe nuk kemi me vendos skele per me ar dhe masteri i emergjencav mi kontrollu skelet.Masteri i emergjencave është i pa nevojshem. e pika c) duhet larguar si kerkesë. Edhe te pika d) duhet larguar nga kerkesa pjesa e fjalisë te qertifikuar per ndriqim publik,apo ti shtohet fjalia ose tek. i elektros sepse diploma 4 vjeqare e elektros dhe pervoja e punes është me ne rregullt se i perfshin shum landë te elektros (instalime elek,ndriqime, rrjeta elektrike materiale elektrike makina elektrike e te gjitha kto e kompletojn një punë te mirëfillt te një tekniku te elektros) se sa ajo qerti fikate që është marr mbrenda ores ose pa qen fare ne trajnime. projekt apo paramas nuk kemi prodhim te shtyllav apo lirav metalik por kemi furnizimi dhe vendosja,kshtu qe mirmbajtja e ndriqimit publik nuk kryhet ne puntori ,prandaj kjo pik duhet larguar si kerkesë. kjo vlen edhe per piken g) minimumi një puntor iqertifikuar per kran sepse kranin qe e kin parapa prej 20m ngritja e krahut nuk na sherben sepse nuk kemi paisje apo ndoni material per te vendosur ne një lartsi te till 20m por deri ne 9m qe ky puntor i qertifikuar per kran dhe krani 20m jan per pun tjera e jo per natyren e ksaj kontrate,prandaj kjo pikë si kerkesë duhet te largohet.

Pika h)Minimumi një puntor i qertifikuar per menagjimin e pikave matse te energjisë elektrike – kjo punë i perket Kecit e jo neve si kompani qe mirrem me mirëmbajtje te paisjev te ndriqimit publik si ne paramasë,dmth nuk kemi asnjë pozicion qe mirret me menagjim apo verifikim te pikave matese, kshtu qe edhe kjo pikë duhet te largohet si kriter ne dosjen e tenderit.

i)Minimumi 7 puntoret e qertifikuar per siguri dhe shendet ne punë si dhe ndaj zjarritpytja jon lidhur me ket kerkesë:Përse 7 puntor te qertifikuar edhe ndaj zjarrit,qka me ba kompania me kta zjarr fiksa,ku mi inkuadru. Ne ket pikë duhet te largohet nr i 7 puntorve te jet 3 ose 4 per siguri dhe shende dhe te largohet nga kerkesa i qertifikuar edhe ndaj zjarrit,sepse zjarr fiksa nuk na duhen per ket projekt,sepse mjafton ajo pjesa e qertifikuar per siguri dhe shendet ne punë.

Kemi kerku sqarim nga AK por kerkoi edhe nga ju si OSHP dhe te beni analizë,qe per ket projekt gjithësejt jan te kerkuar 19 puntor me inxhinjera,lind edhe kjo pyetje per qka na duhen sepse me tre puntor ne teren sepse 2 apo 3 ditë ne javë e shpesh her edhe ne muaj sepse nuk ka punë ma shum ne ket kontratë (qe munden me qenë 90 ditë punë per dy vite. Ne ket rast AK ka kerku 17 puntor17x500.00 si pag mujore =8,500.00ket shifer te pagav per 1muaj e shumzojm per 24 muaj=204,000.00 vetem per 17 puntort e kerkuar- Aka Munds kjo per O.E qe ti punsoj kta puntor qe prej ktyre 14 jan jasht profesini e ti mbaj 24muaj pa ba asgjë).

Vazhdojm per Kërkesat mbi mundësitë teknike dhe/ose profesionale,9.2- te Mekanizmi punuesKërkesa 5. Paisjet te cilat duhet larguar nga kriteret e ksaj dosje te tenderit per te cilat nuk kan zbatim ne bazë te natyres se projektit dhe paramases se dhen ne dosje qe jan:pika a)Cilindri per ngjeshje , Pika c)Makina per shpim nen rrugë largsia e shpimit minimum 50m, tash per ket pikë kerkoi sqarim, ne K.omonen e Shtimes ku kemi rrug 50m gjersi edhe ktu skemi te bejm fare me ket pikë sepse kemi te bejm me mirmbajtje te ndriqimit publik,per arsye se nuk ka zgjerim te ndriqimit sipas paramases,e as ndrrim shtyllave,sepse ne paramas ne as nji pozicion nuk kemi ndoni lloje te shtyllave (metalike,betoni apo druri).

Pika d)Qka naduhet kjo makin hidralike qe vendoset ne eskavator per hapje te kanalit me sistemin me zingjir me grryerje min 1copë,kur ne posedojm bager skip ose eskavator,dmth. Nuk ashtë me ransi me qka e hap kanalim, me ransi ashtë hapja e kanalit,sepse forma me zingjir është per vende dhe raste tjera jo per rastin ton,sepse sipas paramases nuk kemi zgjerim pershkak mungeses se shtyllave,dhe ky nuk mun te perdoret per gropim per gjetje te ndoni defekti. Duhet larguar kjo pikë si kerkesë ose te shtohet fjalia (ose bager )-per arsye se nuk ka zgjerim te ndriqimit sipas paramases,e as ndrrim shtyllave,sepse ne paramas ne as nji pozicion nuk kemi ndoni lloje te shtyllave (metalike,betoni apo druri).

Pika i)Gjysum rimorkjo-kompresor per thyrje te pjesve te forta min 1.5ton min 1copë-per punet e kti projekti apsolut nuk duhet fare kur jan patsjet tjera mete avansuar sepse nuk jemi ne mirmbajtje te rrugve dhe hapje te rrugve te reja, sepse sipas paramases nuk kemi zgjerim pershkak mungeses se shtyllave e atëher qko do te thejsh.- Duhet larguar kjo kerkesë

Pika j)Kamioni kiper kran me gjatsi min 20m 1copë,-te kjo makineri lind pytja pse është caktu min 20m qka na duht ky mekanizem kran me ket gjatsi te kranit min 20 kur as nji paisj ne ket tender nuk asht me lart se 9m (pjasa e fjalis min 20m lartsi duhet te largohet).

Pika k)kombi transportues min 1copë.-Lind pytja qka me transportu me ket kombi kur puntoret per ket projekt udhtojn me mekaniztm adekuat auto shport,tre puntor me njerem dhe nese ka kerkesa edhe tre puntor tjer shkojn me autokorpen e dytë. Atëher kombi transportues vetem per bartje te nxansve mi dergu ne shkolla. -Duhet larguar kjo pikë si kerkesë

Pika M)Kamioneta min2copë, Lind pytja perse dy kamineta,qka me bart me dy kamioneta per ket projekt kur mjafton nji. Sepse nuk ka zgjerim te ndriqimit sipas paramases,e as ndrrim

shtyllave,sepse ne paramas ne as një pozicion nuk kemi ndoni lloje te shtyllave (metalike,betoni apo druri).

Pika N)Lugë ngarkuse me fshisë min 1com-Lind pytya per qka kjo lugë ngarkuse me fshisë per mirmbajtje te ndriqimit publik,sigurish e keni parapa me i shku mbrapa autoshpertes qe gjat punes ne regullimin e ndoni drite apo kablle,e nese bie një copë kabell ne tokë apo ndoni shpuzë e duhanit nga puntoret kjo lugë me njiher me pastru. (kto fjali qe i ceka pak qesharake duken por shum ma qesharake jan kto kerkesat 90% te tyre qe i ceka deri me tash). -Duhet larguar kjo pikë si kerkesë- sepse nuk ka zgjerim te ndriqimit sipas paramases,e as ndrrim shtyllave,sepse ne paramas ne as një pozicion nuk kemi ndoni lloje te shtyllave (metalike,betoni apo druri).

Nga organi shqyrtues kerkoi qe ta njoftoni AK te K. se Shtimes –Zyren e prokurimit qe ti merr hapat e duhur qe ti largoi te gjitha ato qe i ceka deri me tash por edhe ndoni prj shkeljeve qe ju si OSHP e vreni qe jan te teperta per ket projekt,lete vendoset stafi punues dhe mekanizmi ne bazë te natyres se projektit qe ne ket rast kemi te bejm me Mirëmbajtje te ndriqimit publik.Arsyjet e ktyre kerkesave apo kriterave ju si organ shqyrtus i prokurimit i dini shum më mirë se sa ne si oprator ekonomik.

Duke unisur nga kto AK –Zyra e prokurimit ka synim qe paraja publike te mos keq perdoret por te shkoji ne ato vende- ku gjen zbatim ne infrastruktur,kanalizim,ndriqim etj. per te m Kerkoi nga ju qe ta riktheni ket dosje ne verifikim te ktyre kriterave te cekura me lart (te largohen), dhe ti vendosni kriteret ne bazë te natyres se tenderit sipas krpp,(qe per krpp po e shfrytzoj rastin qe sipas neve është shum “pasive” dhe si rezultat i kti pasiviteti te krpp është stermush me lendë apo ankesa oshp-ja). Prandaj këto kërkesat mbi mundësitë teknike dhe profesionale te parashtruara nga AK-Zyra e prokurimit ne Shtime, janë të pa nevojshëm, jo relevante me aktivitetin e prokurimit, diskriminues dhe në kundërshtim me dispozitat e LPP-se, te cekura me lartë, sepse këto kriteret diskriminuese kufizojnë konkurrencën e hapur dhe te lirë për shumë operator ekonomik te cilët kanë aktivitet primar punët e kësaj natyre. Ne kërkojmë qe kërkesat e cekura me lartë ti largoni në mënyrë që vetëm ato të cilat janë relevante me aktivitetin dhe të mbështetura në dispozita ligjore të LPP-se, dhe ti vendosni ato te cilat koordinohen me paramasen dhe natyrën e këtij projekti qe do te realizohet.

Përfundim: Kërkojmë nga Organi Shqyrtues i Prkurimit që :

? Të aprovoj Ankesën për rishqyrtim të bazuar;

? Të anuloj njoftimin per kontratë

? Te kthej rastin ne rivlerësim dhe vlerësimi të bëhet në pajtim me LPP dhe Rregullat dhe RRPP.

? Te vendosen kriteret ne perputhshmeri me natyren e projektit te kerkesa mbi mundsin teknike dhe profesionale,te cilat kriteret jan prezente ne kontratat paraprake te ksaj natyre.

? Te kerkohet stafi profesional qe i perket elektroteknikes apo natyres se punimeve,e jo me kerku lloje te ndryshme te qertifikatave te cilat mirren mbrenda dite.

? Te kerkohet mekanizmi qe hyn drejt perse drejti ne realizimin e kti projekti e jo me pas paisje te pa nevojshme veq ne letra,a zbatimi ityre nuk realizohet sepse nuk ka mundsi.

Mbetemi me shpresë se Ankesa jonë do të shqyrtohet pozitivisht. Me nderime, Malush Krasniqi –perf. ne kompani

## KRITERET PËR VLERËSIM

<p>Kërkesa 4. Operatori ekonomik duhet të ofroj dëshmi për Stafin profesional ; a)Min nje inxhinier I diplomuar i elektroteknikes sistemi 5 vjeqar ose master i certifikuar per sistemin e menaxhimit te eficiences te energjise.i angazhuar edhe ne te drejt te menagjerit te projektit min 10 vite pervoje pune pas diplomimit. b) Min nje inxhinier i diplomuar i elektroteknikes sistemi 5 vjeqar min 7 pervoje pune. c) Min nje master i emergjencave te kete min 3 vite pervoje pune i certifikuar si ekspert per siguri dhe shendet ne pune nga nje kompani e licencuar nga MPMS. d) OE duhet te ofroj se paku 3 punetor te certifikuar per instalimin e ndriqimit publike. e) Min 2 punetor saldues me ISO 9606- 1 f) Min 1 punetor i certifikuar si elektroinstalues. g) Min 1 punetor i certifikuar per kran mbi kamion. h) Min 1 punetor i certifikuar per menaxhimin e pikave matese te energjise elektrike. i) Min 7 punetoret te certifikuar per siguri dhe shendet ne pune si dhe ndaj zjarrit.</p>	<p>Dëshmia 4. Lista e stafit duhet te dorzohet e nenshkruar dhe e vulosur nga OE,(emri,mbiemri,mosha,prof esioni,poz ne kompani). Per piken a) duhet te deshmohet me Diplomë universitare (kopje të vërtetuar( e noterizuar) –original), CV e nenshkruar nga vet personi. Kontratë të punës valide ose marrëveshje mbi angazhimin. Vendim per menaxherin e projektit te deshmohet me nje deklarate nga OE, si dhe certifikata valide e noterizuara. Per piken B te deshmohet Diplome universitare e noterizuara nga origjinali, CV e nenshkruara nga vet personi, si dhe kontrata e punes valide ose marrveshje per angazhim. Per piken C te deshmohet Diplome universitare e noterizuara nga origjinali, CV e nenshkruara nga vet personi dhe kontrate te punes valide ose marrveshje per angazhim si dhe Certifikata e noterizume. Per Piken d, te deshmohen kontrata e punes valide ose marrveshje per angazhim, si dhe certifikatat e noterizuara valide. Per Piken e,f,h,g te deshmohen kontrata e punes valide ose marrveshje per angazhim, si dhe certifikatat e noterizuara Per Piken i te deshmohen kontrata e punes ose marrveshje per angazhim, si dhe certifikata e noterizume</p>
<p>Kërkesa 5. Raporti për mjetet, stabilimentet dhe paisjet teknike që janë në dispozicionin tuaj për realizimin e projektit, Paisjet Teknike a) Cilinder per ngjeshje max 1 ton min 1 cope, b) Prerese per beton dhe asfalt min 2 cope, c) Makine per shpime nen rruge largesia e shpimit min 50 m, e d) Makine hidraulike qe vendoset ne eskavator per hapjen e kanalit me sistem zingjir me grryrje min 1 cope f) Kamion kiper min 1 cope, g) Auto Korpe( Shporte) min 2 cope, h) Eskavator me gome max 6 tone min 1 cope , i) Gjysem rimorkio-kompresor per thyerje te pjeseve te forta min 1.5ton min 1 cope, j) Kamion kiper me kran me gjatesi min 20m min 1 cope , k) Kombi transportues min 1 cope. M) Kamionete min 2 cope . N) Luge ngarkuese me fshise min 1 cope</p>	<p>Deshmia 5. Lista e mjeteve të punës (e nenshkruar dhe e vulosur), operatori ekonomik, per automjete qe nuk regjistrohen nga pika (A-D) Deklaratat unike doganore apo faturat e blerjes duke I bashkangjitur edhe dudin doganore. Per automjetet qe regjistrohen nga pika ( F-N) librezat e qarkullimit me validitet. Në rast se OE nuk posedon pajisjet mbi pronësinë duhet të ofroj marrëveshjen për marrjen me qira të pajisjeve. Marrëveshja duhet të jetë në emër të këtij projekti me validitet të kohëzgjatjes të kësaj kontrate e nënshkruar dhe vulosur nga të dyja palët dhe e noterizua</p>

## RAPORTI I KOMISIONI VLERËSUES

Duke u marr për bazë se OE ankues është ankuar para procesit të hapjes së tenderëve në kritere të përcaktuar nga AK në NJ dhe DT, nuk ka raport të vlerësimit për këtë aktivitet të prokurimit.

## INFORMACIONET SHITESË TË MARRA ME ANË TË SQARIME TË KËRKUARA NGA EKSPERTI SHQYRTUES/TEKNIK

## VLERËSIMI SIPAS NENIT 4.1.26 TË LPP

Të jepet një vlerësim se OE ankues është pale me interes sipas nenit 4.1.26 të LPP-së.

## VENDIMET E MËPARSHME TË OSHP LIDHUR ME RASTET E NGJASHME

N/A

## ARSYETIMI PËR DEVIJIM NGA PRAKTIKA E MËPARSHME

N/A

## PËRGJIGJE NË PRETENDIMET ANKIMORE TË OE ANKUES - TONI INGJINJERING

**Përgjigjeje në pretendimin nr. 1** Eksperti shqyrtues, pas ekzaminimit të dosjes së tenderit, shqyrtimit të rrjedhës së procedurës së tenderimit dhe pretendimeve të palës në ankesë sqaron me sa vijon:

Lidhur me pretendimin e operatorit ekonomik ankues, se OE 'TOINI INGENERING' SH.P.K ka qenë: 1. Ndriqimi publik ekziston dhe është i kryer ne disa forma: Rrjet ajror neper shtylla ekzistuese te rrjetit elektrik dhe shtylla metalike vetëm për ndreqim dhe forma tjetër rrjet nen



taksor, janë te vendosura trupat ndriçues lled, Atëherë çka na duhet **inxh i certifikuar për sistemin e meningjtit të evidencës te energjisë**, sepse ky inxh. Ka te bëjë ma shume me projektim dhe llogaritje për ndonjë projekt qe do te realizohet ne ndoni rrugë të pa ndriçuar nga fillimi deri ne përfundim. (për këto punë te këtij tenderi nevojitet një inxhinier i elektros ndërsa çdo inxh. me tepër nëse një kompani e prezanton me letra ne dosje te tenderit ato janë vetëm dokumente te shitura për ofertim e qe ai inxh. ska me qen ne realizim te këtij projekti, ketë e dinë edhe AK sepse munden me i verifikua OE qe kanë dhe qe kanë pas kontrata dhe me çfar stafi i kanë realizua.)-për ketë vetëm një inxh. i elektros duhet te figuroi ne kërkesë ndërsa kërkesa te pika a) duhet larguar si kërkesë.

**Eksperti shqyrtues sqaron**, duke u bazuar në analizën e fakteve/dëshmime të dokumentuara në platformën elektronike e-prokurim, rrjedhën dhe analizën procedurës së prokurimit në këtë aktivitet të prokurimit, AK ka publikuar njoftimin për kontrate dhe dosjen e tenderit duke zbatuar **procedurë e hapur**, lloji i kontratës: **Kontratë Publike Kornizë – Shërbime me një OE ekonomik**, vlera e parashikuar e kontratës: **150,000.00 €**. Sa herë që paraqiten probleme për autoritetin kontraktues, ato duhet te analizohen në mënyrë sa me detale nga stafi përgjegjës për aq sa është e mundur ne mënyrë, që të përmbushim nevojën apo të zgjidhim problemin e autoritetit kontraktues sa më mirë, në mënyrë më efikase dhe të drejt të shfrytëzimi te fondeve publike, duke përcaktuar kushtet dhe rregullat që do të zbatohen, duke përcaktuar **kriteret e përzgjedhjes dhe kriterin e dhënies**. Përgjegjësia mbi përzgjedhjen e kriterëve të përzgjedhjes dhe kriterëve të dhënies, bie apo është përgjegjësi mbi/e autoritetin kontraktues. Është në **diskrecion të Autoriteti kontraktues** të vendos se cilat kriteret të përzgjedhës do të përcaktohen, në mënyrë që OE të interesuar kërkohet të dorëzojnë në mënyrë që të kualifikohen duke plotësuar kërkesat e dosjes se tenderit dhe njoftimit për kontrate, mirëpo të gjitha kërkesat minimale për kualifikim duhet të jenë drejtpërdrejt relevante dhe proporcionale për objektin e kontratës në fjalë, sipas nenit **51 par. 1 të LPP-se**, po citoj: "**Autoriteti kontraktues duhet të theksojë në njoftimin e kontratës dhe të përcaktojë në tërësi në dosjen e tenderit të gjitha kriteret e përzgjedhjes që një operator interesuar ekonomik duhet ti përmbushë për tu konsideruar si i kualifikuar: (i) në rast të procedurave të hapura dhe procedurave të kuotimit të çmimit për dhënien e një kontrate; Të gjitha kriteret e përzgjedhjes duhet të kufizohen vetëm në kriteret e nevojshme për të siguruar se vetëm operatorët ekonomik që posedojnë aftësitë e nevojshme profesionale, financiare dhe teknike për ti përmbushur kushtet e kontratës përkatëse do të konsiderohen të kualifikuar për të marrë një kontratë të tillë ose për marrjen e ftesës për tenderim. Në asnjë rast, autoriteti kontraktues nuk duhet që të përfshijë, saktësojë ose përdorë kriteret e përzgjedhjes që bazohen në konsiderata të tjera përveç atyre të lejuara nga dispozitat e neneve 65-70 të këtij ligji**".

Kërkesa e AK në DT/FDT, kërkon të ketë një inxhinier të diplomuar të elektroteknikës me një sistem 5-vjeçar **OSE** një master të certifikuar për sistemin e menaxhimit të eficencës së energjisë. Me qen sa AK ka kërkuar inxhinier të diplomua **OSE** master të certifikuar, megjithatë, pretendimi aktual nuk është i **qëndrueshëm**.

**Përgjigjeje në pretendimin nr. 2** Lidhur me pretendimin e operatorit ekonomik ankues, se OE "TONI INGENERING" SH.P.K ka qenë mirëmbajtja e ndriçimit publik është punë mobile sepse brenda një dite stafi punues me dy punëtor teknik i kontrollojnë dhe ndërrojnë trupat ndriçues në disa rrugë p.sh. Ne rrugën Adem Jashari i ndërrojnë dy trupa ndriçues të djegur për disa minuta, tani kalojnë te kërkesa me radhë ne rrugët tjera e që këto bahen përmes auto shportës, kështu qe nuk kemi me vendos skele për me ardhe mastari i emergjencave mi

kontrollua skelet. Masteri i emergjencave është i pa nevojshëm. e pika **c**) duhet larguar si kërkesë. Edhe te pika **d**) duhet larguar nga kërkesa pjesa e fjalisë të certifikuar për ndreqim publik, **apo ti shtohet fjalia ose tek. i elektros** sepse diploma 4 vjeçare e elektros dhe përvoja e punës është me ne rregullt se i përfshin shume landë te elektros (instalime elek ,ndriçime, rrjeta elektrike materiale elektrike makina elektrike e te gjitha këto e kompletojnë një punë te mirëfilltë te një tekniku te elektros) se sa ajo qerti fikat qe është marr brenda orës ose pa qen fare ne trajnime. **Pika e)** Minimumi 2 punëtor saldues me ISO 9606-1 duhet larguar nga kërkesa Për arsujë se ne 5/9 projekt apo pames nuk kemi prodhim te shtyllave apo lirav metalik por kemi furnizimi dhe vendosja, kështu që mirëmbajtja e ndriçimit publik nuk kryhet në punëtori ,prandaj kjo pik duhet larguar si kërkesës. kjo vlen edhe për piken g) minimumi një punëtor identifikuar për kran sepse kranin qe e kin parapa prej 20m ngritja e krahut nuk na shërben sepse nuk kemi pajisje apo ndani material për te vendosur ne një lartasi te tillë 20m por deri ne 9m qe ky punëtor i certifikuar për kran dhe krani 20 m janë për pun tjera e jo për natyrën e kësaj kontrate, prandaj kjo pikë si kërkesë duhet te largohet.

**Eksperti shqyrtues sqaron** duke u bazuar në analizën e fakteve/dëshmime të dokumentuara në platformën elektronike e-prokurim, rrjedhën dhe analizën procedurës së prokurimit në këtë aktivitet të prokurimit si dhe kriteret e përzgjedhjes dhe kriterin e dhënies. Përgjegjësia mbi përzgjedhjen e kriterëve të përzgjedhjes dhe kriterëve të dhënies, bie apo është përgjegjësi mbi/e autoritetin kontraktues. Është në diskrecion të Autoriteti kontraktues të vendos se cilat kriterë të përzgjedhës do të përcaktohen në një proces të tenderit.

Gjithashtu,Eksperti shqyrtues sqaron (sa i përket kërkesë në DT/FDT dhe Njoftimit për informata shtesë ose përmirësim i gabimit tek Kërkesat mbi mundësitë teknike dhe/ose profesionale 9.1 & 9.2 për **piken c**. OE nuk ka ofruar fakte të mjaftueshme përse kërkesë në fjalë është diskriminuese dhe duhet larguar duke u bazuar se një Operator Ekonomik të ketë një person të certifikuar në bazë të Ligjit 04/L-161 për Sigurinë dhe Shëndetin në Punë është e rëndësishme për të garantuar sigurinë dhe shëndetin e punëmarrësve në vendin e punës. Këtu janë disa aspekte të rëndësisë së këtij ligji:

**Përgjegjësia Ligjore:** Ligji 04/L-161 përcakton detyrimet dhe kërkesat për sigurinë dhe shëndetin në punë. Operatorët Ekonomikë janë të detyruar të përmbushin këto kërkesa për të garantuar që punëmarrësit janë të mbrojtur nga rreziqet e mundshme në vendin e punës.

**Përmirësimi i Kushteve të Punës:** Personi i certifikuar për sigurinë dhe shëndetin në punë mund të ofrojë këshilla dhe rekomandime për përmirësimin e kushteve të punës. Kjo përfshin organizimin e trajnimeve, kontrollin e pajisjeve dhe ndërtimin e një kulture të sigurisë në vendin e punës.

**Zbatimi i Rregulloreve dhe Standardeve:** Personi i certifikuar njeh rregulloret dhe standardet e sigurisë dhe shëndetit në punë. Ai/ajo mund të ndihmojë në zbatimin e tyre dhe të sigurojë që Operatorët Ekonomikë janë në përputhje me këto udhëzime.

**Përgjegjësia ndaj Punëmarrësve:** Operatorët Ekonomikë kanë përgjegjësi ndaj punëmarrësve të tyre për sigurinë dhe shëndetin në punë. Përdorimi i një personi të certifikuar ndihmon në përmbushjen e kësaj përgjegjësie.

Megjithatë, pretendimi për piken e lartë përmendur nuk është i **qëndrueshëm**.

**Pika d.** OE duhet ofroj se paku 3 punëtor të certifikuar për instalimin e ndriçimit publik duke



u bazuar ne analizën e fakteve/dëshmime te dokumentuara ne platformën elektronike e-prokurim, rrjedhën dhe analizën procedurës se prokurimit në këtë aktivitet të prokurimit, se AK me rastin e përgatitjes së dosjes se tenderit dhe njoftimit për kontratë për këtë aktivitet të prokurimit duhet të që OE/tenderuesit duhet lejuar të ofrojnë certifikata/diploma ekuivalentë apo të barasvlershme. Prandaj duke u bazuar në këto fakte analizës se dokumentacionit te prezantuar dhe analizës se mësipërme, pretendimet e palës ne ankesë, në këtë pikë janë të **qëndrueshme**.

**Pika e.** Eksperti shqyrtues sqaron, se duke u bazuar në analizën e fakteve/dëshmime të dokumentuara në platformën elektronike e-prokurim, rrjedhën dhe analizën procedurës së prokurimit në këtë aktivitet të prokurimit, se AK me rastin e përgatitjes se dosjes së tenderit për këtë aktivitet te prokurimit ku AK, autoriteti kontraktues është dashur të ketë parasysh edhe **nenin 7 par. 2 te LPP-së**, ku thotë: “Autoriteti kontraktues nuk do të ekzekutojë asnjë aspekt të aktivitetit të prokurimit në një mënyrë që redukton apo eliminon konkurrencën në mes të operatorëve ekonomik ose që diskriminon në dëm ose në të mirë te një ose më shume operatoreve ekonomik”, sepse dosja e tenderit si dokumente themelore mbi te cilin OE/Tenderuesit përgatitin ofertat e tyre është dashur të kërkohen ISO standarde apo diploma ekuivalentë me ISO 9606.

Prandaj duke u bazuar në këto fakte analizës së dokumentacionit të prezantuar dhe analizës së mësipërme, pretendimet e palës ne ankesë, në këtë pikë është pjesërisht i qëndrueshme.

**Pika g.** Eksperti shqyrtues sqaron, se duke u bazuar në analizën e fakteve/dëshmime të dokumentuara në platformën elektronike e-prokurim, rrjedhën dhe analizën procedurës së prokurimit në këtë aktivitet të prokurimit, lidhur me kërkesën në fal AK me rastin e përgatitjes së dosjes se tenderit dhe njoftimit për kontratë për këtë aktivitet të prokurimit duhet të që OE/tenderuesit duhet lejuar të ofrojnë certifikata ekuivalentë apo të barasvlershme. Prandaj duke u bazuar në këto fakte analizës se dokumentacionit te prezantuar dhe analizës se mësipërme, pretendimet e palës ne ankesë, në këtë pikë janë të qëndrueshme.

**Pika h.** Sa i përket kriterëve të përzgjedhjes dhe kriterin e dhënies. Përgjegjësia mbi përzgjedhjen e kriterëve të përzgjedhjes dhe kriterëve të dhënies, bie apo është përgjegjësi mbi/e autoritetin kontraktues. Është në diskrecion të Autoriteti kontraktues të vendos se cilat kriterë të përzgjedhës do të përcaktohen, por tek pika h AK të sigurohet se është pajtim me LIGJI Nr. 05/L – 085 PËR ENERGJINË ELEKTRIKE andaj ky pretendim ankimor është pjesërisht i qëndrueshëm.

**Pika i, Eksperti shqyrtues sqaron,** në bazë të kërkesave në DT/FDT dhe Njoftimit për informata shitesë ose përmirësim të gabimeve, është e rëndësishme që AK të mos kërkojë apo të paraqesë kërkesa diskriminuese. Përveç kësaj, duhet të sigurohet që brenda kërkesave të lejohen kushte të mjaftueshme edhe për operatorë ekonomikë të rinj që të aplikojnë. Mendimi i ekspertit shqyrtues është se ky pretendim ankimor **është pjesërisht i qëndrueshëm**. Është e rëndësishme që të vlerësohet secila kërkesë me kujdes dhe të sigurohet që të përmbushen standardet e nevojshme për të garantuar një proces të drejtë dhe të barabartë për të gjithë operatorët ekonomikë.

### **Përgjigjeje në pretendimin nr. 3**

Lidhur me pretendimin e operatorit ekonomik ankues, se OE 'TOINI INGENERING" SH.P.K për Kërkesat mbi mundësitë teknike dhe/ose profesionale, në FDT dhe Njoftim për informata shtesë ose përmirësim i gabimeve 9.2 është i pa kënaqur me **Kërkesa 5,pika a)** Cilindri për ngjeshje, **Pika c)** Makina për shpim nën rrugë largësia e shpimit minimum 50 m, **Pika d)** Makine hidraulike që vendoset në eskavator për hapjen e kanalit me sistem zingjir me gërryerje, **Pika i)** Gjysmë rimorkio-kompresor për thyerje të pjesëve të forta min 1.5 ton, **Pika j)** Kamion kiper me kran me gjatësi min. 20m, **Pika k)** Kombi transportues, **Pika M)** Kamionete min 2, **Pika N)** Luge ngarkuese me fshise.

**Eksperti shqyrtues sqaron:** (pikat a, c, d, i, j, k, m, dhe piken n) tek kërkesa mbi mundësitë teknike dhe/ose profesionale 9.2 Kapaciteti teknik dhe profesional është kërkuar lista e mjeteve të punës (e nënshkruar dhe e vulosur), operatori ekonomik, për automjete që nuk regjistrohen nga pika (A-D) Deklaratat unike doganore apo faturat e blerjes duke i bashkangjitur edhe dudin doganore. Për automjetet që regjistrohen nga pika ( F-N) librezat e qarkullimit me validitet. **Në rast se OE nuk posedon pajisjet mbi pronësinë duhet të ofroj marrëveshjen për marrjen me qira të pajisjeve.** Marrëveshja duhet të jetë në emër të këtij projekti me validitet të kohëzgjatjes të kësaj kontrate e nënshkruar dhe vulosur nga të dyja palët dhe e motorizuar. Duke u bazuar në kërkesën dhe faktet se AK ka lejuar **marrëveshjen për marrjen me qira të pajisjeve** atëherë ky pretendim ankimor është i pa qëndrueshëm.

## REKOMANDIMI I EKSPERTIT SHQYRTUES

Duke u bazuar në faktet, sqarimet e lartpërmendura dhe të gjeturat tjera në këtë raport, eksperti shqyrtues i propozon panelit shqyrtues që ankesa e OE ankues të aprovohet si pjesërisht të bazuara (për arsyen të cilat janë cekur tek përgjigja në pretendimet si më lartë), dhe të njëjtin tender rekomandon që autoriteti kontraktues të bëjë përmirësimin e dosjes së tenderit dhe zgjatjen e afatit për dorëzimin e ofertave konfirmo nenit 53.7 të LPP-së.

Raporti i ekspertit shqyrtues, lidhur me ankesën e parashtruar nga OE “**TONI INGJINJERING**”, lidhur me aktivitetin e prokurimit “**Mirëmbajtja e ndriçimit publik ( kontratë kornizë dy vjeqare)**” me numër të prokurimit: “**617-24-1985-2-1-1**, të iniciuar nga Autoriteti Kontraktues (AK) – **KOMUNA SHTIME**

Raporti i ekspertizës ti dorëzohet:

- Autoritetit Kontraktues – **KOMUNA SHTIME**
- Panelit Shqyrtues – **OSHP**
- OE ankues – **TONI INGJINJERING**



**Shkelzen Hoxha**